



01.08.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

Nësimi org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	47160	2

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 14.09.2021, lidhë këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Mirëkuptimit
në mes të
Theodora Sh.P.K

dhe
Komunës së Suharekës

Neni 1
Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe në mes të “Theodora Sh.P.K” , të përfaqësuar nga **Sergio Borgo, Drejtor i përgjithshëm**, dhe në mes të Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të Analizimi i lojërave të futbollit të cilat transmetohen në mjetet e informimit .

Neni 2
Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parashih punësimin e 30 të rinjëve në këtë projekt në periudhë prej 6 muaj.

Neni 3
Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1** Komuna me qëllim të krijimit të ambientit dhe ofrimin e resursëve humane për realizimin e kësaj marrëveshjetë për “ Analizimi i lojërave të futbollit të cilat transmetohen në mjetet e informimit
- 3.2.** Sh.P.K. “**Theodora** “ në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për sigurimin e mjeteve financiare për të punësuarit në këtë projekt .

Neni 4
Obligimet e Shoqatës

4.1 Sh.P.K. “**Theodora** “ është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e punësimit të 30 të rinjëve nga Komuna e Suharekës për periudhën 6 muaj për vitin 2022.

4.2 Sh.P.K. “**Theodora** “ merr përsipër të gjitha obligimet financiare sa i përket qëllimit të këtij memorandumi.

Neni 5 Afati i Realizimit

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2022

Neni 6 Obligimet e Palëve

6.1 Komuna e Suharekës, do të kujdeset në ofrimin e kapaciteteve të resurseve humane të cilat i ka në dispozicion

6.2 Theodor Sh.P.K merr përsipër të gjitha detyrimet financiare të cilat lindin gjatë realizimit të këtij projekti.

Neni 7 Interpretimi dhe Ndryshimi

7.1 Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

7.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 8 Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 9 Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 10 Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHJE

**Theodora Sh.P.K
Sergio Borgo**



Drejtor



01 Gusht 2022
Komuna e Suharekës